



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1264 prot.

Fushë-Arrëz, më 05.05.2025

VENDIM

Nr. 15, datë 28.04.2025

PËR

**RISHQYRTIMIN E VENDIMIT NR.4, DATË 27.01.2025, "PËR PËRCAKTIMIN E
ÇMIMIT TË QIRASË MESATARE TË NJËSIVE TË BANIMIT DHE
APARTAMENTEVE NË TREG, PËR EFEKT TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË
NË BASHKINË FUSHË-ARRËZ PËR VITIN 2025"**

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; Ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social"; VKM Nr.362 dt. 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij"; VKM Nr.459, dt. 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin"; Shkresës së Prefektit të Qarkut me Nr. 124/1 prot, datë 17.02.2025 "Mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.4, datë 27.01.2025", ku kërkohet rishqyrtim i vendimit të Këshillit Bashkiak nr.4, datë 27.01.2025, duke bërë plotësim të aktit edhe për zonat rurale në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz, kjo në respekt të parimit të gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit;

Referuar ofertave të marra në treg për çmimin e qirave në qytetin Fushë-Arrëz dhe në zonat rurale për vitin kalendarik 2024; Bazuar në projektvendimin e propozuar nga zyra e shërbimit social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, si dhe pas shqyrtimit të sugjerimeve të Prefektit në lidhje me përfshirjen e zonave rurale në përlllogaritjen e çmimit të qirasë mesatare të njësive të banimit, **Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 28.04.2025**, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura edhe për zonat rurale,

VENDOSI :

Miratimin e çmimit mesatar të qirave të banesave për efekt subvencionimi të qirasë sipas strukturës për zonën urbane dhe zonat rurale në Bashkinë Fushë-Arrëz për vitin 2025 si më poshtë:

	Zonë urbane	Zonë rurale
a) Për apartment të tipit "Garsionere":	7000 lekë/muaj	5000 lekë/muaj
b) Për apartment të tipit 1+1:	12000 lekë/muaj	8000 lekë/muaj
c) Për apartment të tipit 2+1:	15000 lekë/muaj	10000 lekë/muaj
d) Për apartment të tipit 3+1:	23000 lekë/muaj	13000 lekë/muaj

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Fushë-Arrëz, Komisioni i Strehimit Social i ngritur me urdhër të Kryetarit të bashkisë, Zyra Juridike dhe Zyra e Financës.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

12 vota pro

0 vota kundër


0 vota abstenim

Zbardhur, më 05.05.2025.

Ky Vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike sipas pikës 6, neni 55 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

